



RENOFIX 75

LLAÇ PËR MURATIM PREJ ÇIMENTOS DHE GËLQERES

Detyrimisht përmbahuni udhëzimit teknik

HAPËSIRAT E PËRDORIMIT

Llaç prej çimentos dhe gëlqeres nga grupi i II i llaçeve për muratim të të gjithë llojeve të murit (tulla, bllok betoni) në kërkesat më të larta statike. Është i përshtatshëm sidomos për punë gjatë rinovimit. Me këtë llaç kursethet koha e furnizimit më të mirë, çimento dhe gëlqere.

PËRMBAJTJA

- Çimento
- Gur gëlqeror të kualitetit të lartë
- Përbërës organikë <5%

VEÇORITË

- Lidhshmëri të mirë me bazamentin
- Produktivitet i lartë
- Punohet mirë me mistri

PËRGATITJA E BAZËS

Tullat (blloqet) duhet të jenë të thata dhe të pastra. Tullat shumë të thata dhe tullat që kanë thithshmëri të lartë, para përdorimit duhet të zhyten në ujë.

PËRGATITJA E LLAÇIT

Një thes Renofix 75 përzihet me mikser për 2 minuta me rreth 7-8 litra ujë të pastër deri në arritjen e masës homogjenike. Pastaj materiali mund të përdoret. Sipërfaqja e murit duhet patjetër të jetë e pastruar nga pluhuri dhe mbeturinat. Llaçi patjetër duhet shfrytëzuar para ngurtësimit dhe nuk duhet të përdoret gjatë rreshjeve të shiut.

PËRPUNIMI DHE KUSHTET E PËRPUNIMIT



Tulla dhe llaçi të mbrohen nga shiu. Llaçi vendoset me mistri. Tulla vendoset mbi llaç dhe nivelizohet me nivelizues (libellë) dhe me litarin për muratim. Sasia e tepërt e llaçit hiqet me mistri. Niveli i parë i tullave patjetër të jetë i vendosur në mënyrë të sheshtë (i rrafshuar). Gungat (sipërfaqet e pa sheshtuara) patjetër të sheshohen në fugën e mëposhtme.



PËRPUNIMI DHE KUSHTET E PËRPUNIMIT

Fugat horizontale duhet të jenë me gjërësi 12 mm +/-5 mm. Fugat vertikale duhet të kenë gjërësi nga 10-15 mm. Të ruhet nga tkurja dhe tharja e shpejtë. Në kohën e pushimit më të gjatë gjatë punës, mikseri (makina e përzierjes) duhet patjetër të zbrazet dhe të lahet. Nuk duhet përdorur në temperatura më të ulta se +5 C. Nuk duhet përzier me matëriale tjera.

VËRREJTJE

Për udhëzime të hollësishme të sigurisë, këshillohuni me fletët e veçanta të sigurisë. Ju lutemi lexoni broshurën e sigurisë para përdorimit.

PAKETIMI

Renofix 75 furnizohet në thasë letre nga 40 kg që janë të mbrojtura nga lagështia.

DEPONIMI

Ruani në një vend të thatë (nëse është e mundur në paletë druri). Afati i deponimit: 3 muaj sipas Rregullores 1907/2006/EU, Shtojca XVII në 20°C, 65% l. r. e ajrit.

TË DHËNA TEKNIKE

Numri i prodhimit	5319990620200
Shifra e prodhimit	1075
Thasë në paletë	30
Njësia sasiore	40 kg / Thes
Granulacioni	0-3 mm
Sasia e nevojshme e ujit	10 l./Thes
Shënim	Vlerat e harxhimit janë aproksimative dhe varen shumë nga bazamenti dhe teknika e ndërtimit.
Dendësia e materialit kur është i thatë (EN 1015-10)	ca. 1700 kg/m ³
Fortësia gjatë shtypjes pas 28 ditëve (EN 1015-11)	ca. 6,0 N/mm ²
MG (EN 998-1):	M5

Të gjitha të dhënat për materialin pushon së qeni e vlefshme pas lëshimit të kësaj liste. Këto janë të dhënat që rezultojnë nga rrymat e analizave. Jo ligjore mund të lindë detyrimi për këto të dhëna. Produktet RENOVA, si dhe të gjitha të papërpunuara materialet e përfshira në ato i nënshtrohen të vazhdueshme teste për të siguruar konstante dhe të njëjtin nivel të cilësisë. Këshilltarët tanë teknikë janë në dispozicionin tuaj për çdo kërkesë lidhur me Aplikacionin, përpunimin, dhe prezantimin e tona të produkteve. Ju mund ta gjeni të dhënat tona aktuale në www.renova.com.mk, si një "PDF" dokument ose pyesni për ta në dyqanet tona pakicë.

RENOVA MAQEDONI
Xhepcisht / Tetovë
Tel: +389 44 487 300
Fax: +389 44 487 200
info@renova.com.mk

RENOVA SHQIPERI
Picar / Vore
Tel: +355 48 301 909
Fax: +355 48 301 908
tirana@renova.com.mk

RENOVA KOSOVË
Gurëza / Ferizaj
Tel: +381 290 310 222
Fax: +381 290 310 444
ferizaj@renova.com.mk

